

Data _____

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i printimit për nevojat e OSHEE Group sh.a, për një periudhe 3 vjecare”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT- printime dhe shërbime te lidhura me to.

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **116,700,000 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind mijë)** leke, pa TVSH.
- **1,160,963 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre)** euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 25.06.2024 1 euro = 100.52 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyesimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2 Pika 1 e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit kemi te bejme me nje sistem qendror i cili bazohet dhe karakterizohet nga nderlidhja e pashmangshme e disa zgjidhjeve teknologjike, duke bere te mundur vetem ofrimin e shërbimit si nje i tere. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekzekutueshme kontraten pasi eshte nje sistem kompleks dhe i perqendruar.

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **116,700,000 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind mijë)** leke pa TVSH.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022,2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesine e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE

ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo me pak vitet e fundit financiare te jete ne masën **116,700,000 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind mijë)** leke pa TVSH.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 46,600,000 (dyzet e gjashtë milion e gjashtëqind mijë) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj produktesh/shërbimesh, pavaresisht rendesise dhe kompleksitetit të produkteve/shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i çertifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:

- a) **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- b) **ISO 27001:2022** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- c) **ISO/IEC 20000-1:2018** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjise së informacionit (e vlefshme);
- d) **ISO 14001:2015** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit mjedisor (e vlefshme)

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- a) Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar është ne gjendje te kryeje realizimin e kontratës ne fjale ne mënyrë cilësore dhe te plotë, bazuar ne organizimin e brendshëm për menaxhimin sa me te mire te cilësisë implementuese.
- b) Certifikimi **ISO 27001:2013** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar është ne gjendje te kryeje realizimin e kontratës ne fjale duke siguruar qe informacionet (siç janë ato qe përmbajnë sistemet ekzistuese te AK dhe që kanë një rëndësi dhe konfidencialitet te larte, te menaxhohen ne mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe te jene te kontrolluara dhe si dhe aksesit të këto sisteme te jete i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në ketë kontrate do të kete vijim te mirëmbajtjes dhe garancisë se suportit te të dy sistemeve ekzistuese qe kërkojnë kompetence te shtuar profesionale ne këtë drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe ne kategorinë e mbrojtjes kibernetike, për aq sa ekspozohen sistemet ne fjale.
- c) Certifikimi **ISO 20001-1:2018** ose ekuivalent shërben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale duke qene se zoteron nje sistem menaxhimi per sherbimet e teknologjise se informacionit, duke pasur me shume garanci qe ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë te dy sistemet qe kerkohen ne DST, te cilet jane teresisht te bazuar ne produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe ne kategorine e mbrojtjes kibernetike.
- d) Certifikimi **ISO 14001:2015** ose ekuivalent shërben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte vete konform kerkesave te sistemit te menaxhimit mjedisor dhe si i tille krijohet besimi qe eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale ne ambientet e brendshme te autoritetit kontraktor me te njejtat standarte dhe konform kerkesave per te ruajtur apo përmirësuar performancën mjedisore, objektivat mjedisore per sistemet ekzistuese dhe ato qe do blihen rishtasi, pasi shtrirja e tyre gjeografike eshte e madhe dhe impakti mjedisor eshte i konsiderueshem.

2. Operatori Ekonomik duhet të ketë në të paktën 8 (tetë) qarqe te vendit, pika servisi per te siguruar sherbim dhe mirembajtje ne kohe. Vertetuar kjo me QKB ku te figurojne si adresa sekondare ne keto pika.

Argumentimi: kjo kerkese mbeshtetet ne termat e reagimit per realizimin e sevisit ne kohen e caktuar ne terma reference ku eshte parashikuar qe Operatori ekonomik duhet të përgjigjet sipas tabelës se mëposhtme për problemet që shfaqen gjatë procesit të punës (SLA).

Nr.	Përshkrimi	Ndërhyrja	Zgjidhja e problemit pas ndërhyrjes	Total për zgjidhjen e një problemi	Oraret e punës
1	Qarku i Tiranës	50 minuta	20 minuta	70 minuta	E Hënë E Dielë 08:00 – 21:00
2	Qytetet me pak se 100 km nga Tirana	120 minuta	20 minuta	140 minuta	E Hënë E Dielë 08:00 – 21:00
3	Qytetet mbi 100 km nga Tirana	180 Minuta	30 minuta	210 minuta	E Hënë E Dielë 08:00 – 21:00

3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo me pak se 14 punonjës nga të cilët duhet të ketë një numër prej 8 (tetë) inxhinierë të diplomuar në degët e ne fushen e informatikes, elektrike, mekanike, elektronike, fizike, teknologji informacioni, ose mekatronik që do të angazhohen në implementimin e projektit. Kjo të vertetohet me dorëzimin *Listepageses te dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente, per muajin e fundit te maturuar*, kontratave të punës, diplomat dhe CV perkatëse të specialisteve.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit **përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

5. Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se ka te punesuar për të paktën muajin e fundit stafin e nevojshem teknik te kualifikuar per suportimin dhe implementimin e zgjidhjeve te kerkuara. Specialistet e servisit duhet te jene te pajsur me çertifikata nga prodhuesi qe verteton aftesine e tyre per riparimin e paisjeve te printimit, implementim dhe konfigurime te softwareve te kerkuar si dhe te gjithë shërbimit te nevojshem.

Specialiste te servisit do te konsiderohen vetem ata qe jane te pajsur me vertetim nga prodhuesi:

- a. Te paktën 1 (nje) Project Manager të certifikuar për te menaxhuar shërbimin gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.
- b. Te paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për printer BW (black-white) të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kontratës.
- c. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për MFP (multifunction printer – all-in-one) te Vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kontratës.
- d. Te paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për MFP (multifunction printer – all-in-one) te Mesme të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.
- e. Te paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar per MFP (multifunction printer – all-in-one) Color te ofertuar per te implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kontratës.
- f. Të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar për software monitorimi te ofertuar për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kontratës.
- g. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për software menaxhimi te ofertuar për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kontratës.
- h. Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel Associate “CCNA” për Routing dhe Switching për te implementuar dhe integruar me zgjidhjen ekzistuese Cisco Networking për te gjithë pajisjet në të gjithë vendin.
- i. Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel MCSE ose ekuivalente për Infrastruktura për te gjithë konfigurimet e nevojshme te sistemit software ne infrastrukturen e serverave te OS/EE.

Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikate.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit si dhe

operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per te pakten muajin e fundit nga data e hapjes se tenderit.

Nje punonjes mund te kete me shume se nje certificate dhe per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

- *Certifikatat perkatese te kualifikimit per secilin nga specialistet e mesiperme;*
- *Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjeter vertetues, per muajin e fundit nga data e hapjes se tenderit;*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 5 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Konkretisht:

- a. Te pakten 1 (nje) Project Manager të certifikuar për te menaxhuar shërbimin gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

Argumentimi: duke qenë se projekti është shumë kompleks, i shpërdarë në territor dhe me kohëzgjatje të konsiderueshme (3 vjet), kërkohet një project manager i certifikuar që të ndjekë mbarëvajtjen e tij

- b. Te paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për printer BW (black-white) të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kontratës.

Argumentimi: ky kriter mbështetet në sasinë e madhe të pajisjeve bardhë e zi që do të implementohen dhe do të kenë nevojë për suport gjatë periudhës 3 vjeçare.

- c. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për MFP (multifunction printer – all-in-one) te Vogël të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kontratës.

Argumentimi: kjo kërkesë mbështetet në sasinë e madhe të pajisjeve MFP (multifunction printer – all-in-one) të vogla që do të implementohen dhe do të kenë nevojë për suport gjatë periudhës 3 vjeçare.

- d. Te paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për MFP (multifunction printer – all-in-one) te Mesme të ofertuar për të implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Argumentimi: ky kriter mbështetet në sasinë e pajisjeve MFP (multifunction printer – all-in-one) të mesme që do të implementohen dhe do të kenë nevojë për suport të vazhdueshëm gjatë periudhës 3 vjeçare që zgjat kontrata.

- e. Te paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar per MFP (multifunction printer – all-in-one) Color te ofertuar per te implementuar dhe suportuar pajisjet përgjatë kontratës.

Argumentimi: ky kriter mbështetet në sasinë pajisjeve MFP (multifunction printer – all-in-one) me ngjyra që do të implementohen dhe do të kenë nevojë për suport gjatë periudhës 3 vjeçare.

- f. Të paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar për software monitorimi te ofertuar për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kontratës.

Argumentimi: ky kriter lind nga nevoja e implementimit dhe operimit të sistemit te monitorimit të shërbimit të printimit.

- g. Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar për software menaxhimi te ofertuar për të implementuar, konfiguruar, integruar dhe suportuar përgjatë kontratës.

Argumentimi: ky kriter lind nga nevoja e implementimit dhe operimit të sistemit te menaxhimit të shërbimit të printimit.

- h. Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel Associate “CCNA” për Routing dhe Switching për te implementuar dhe integruar me zgjidhjen ekzistuese Cisco Networking për te gjithë pajisjet në të gjithë vendin.

Argumentimi: ky kriter lind nga nevoja e konfigurimit te parametrave të rrjetit për pajisjet e printimit kryesisht për pikat me teknologjinë DMVPN dhe Zyrat qendrore të OSHEE sh.a.

- i. Te pakten 1 (një) specialist te certifikuar ne nivel MCSE ose ekuivalente për Infrastruktura për te gjithë konfigurimet e nevojshme te sistemit software ne infrastrukturen e serverave te OSHEE.

Argumentimi: Kjo kërkesë garanton njohjen në detaje e sistemit Windows server, duke qenë se shërbimi i printimit do të mbështetet në të.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet te dorëzoje dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

6. Autorizimin e kompanisë prodhuese/distributorit te autorizuar (ku te provohet lidhja e distributorit me prodhuesin) drejtuar OSHEE që operatori ekonomik ekonomik është i autorizuar të tregtojë ne territorin e Shqipërisë, markën e pajisjes dhe software që oferton.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit /distributorit te autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar te origjinës së licensave specifike te garancisë që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar. Kjo kërkesë i

shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës.

7. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 10 (dhjetë) mjete transporti mallrash, me qëllim transportin e mallit dhe krijimin e mundësisë të levizjes së specialisteve për të dhënë shërbimin në kohë në të gjithë territorin ku janë të vendosura zyrat e OSHEE GROUP sh.a dhe bijave, të cilat duhet t'i ketë në pronësi, huapërdorje ose me qira.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen shoqëruar me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Leje qarkullimi e mjetit.
- b) Sigurim i mjetit.
- c) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

Sqarim : Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të **formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST**, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi: Meqenëse ky projekt është i shtrirë në gjithë territorin e Shqipërisë dhe patja në dispozicion të këtyre mjeteve është e nevojshme si në shpërndarje në fazën fillestare por dhe përgjigje në kohë të OE në rast defektesh.

8. Operatori Ekonomik duhet të ketë minimalisht 50% e sasisë së paisjeve të ofertuara në stok për të garantuar implementimin e shërbimit brenda afateve të kërkuara. Për vërtetimin e stokut duhet të dërgohen modelet dhe numrat serial të paisjeve sipas faturave të blerjes/deklarate doganore. Komisioni i vlerësimit të ofertave mund të bëjë verifikim në magazinat e operatoreve ekonomik për të vlerësuar nëse ky kriter është plotësuar.

Argumentimi: Duke qenë se implementimi do kryhet prej një faze kohore prej 15 ditësh është e nevojshme që Operatori Ekonomik të ketë stok 50% e sasisë

9. Operatori ekonomik duhet te paraqese kataloge ose broshurë nga prodhuesi per mallin dhe software qe oferton. Katalogu ose broshura duhet te kete te detajuar specifikimet teknike te produktit te ofertuar.

Argumentimi: Ky katalog lidhet njëkohësisht edhe me treguesit të produkteve/sherbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar sipas standardeve bashkekohore të zyrtarizuar ne praktikat e tyre te veprimtarise tregtare.

10. Operatori ekonomik duhet te faktoje teknikisht si do arrij te permbushe kriteret e SLA. Duhet te prezantohet forme e reagimit ne rast problemesh si dhe ku jane te stacionuara qendrat e mbeshtetjes teknike, si do mundesohet ofrimi i sherbimit brenda kohes se kerkuar ne skajet e vendit...etj (plan organizimit, kontrata bashkepunimi etj).

Argumentimi: Meqenëse ky projekt eshte i shtrire ne gjithe teritorin e shqiperise dhe implementimi do kryhet per nje kohe te shkurter ky dokument nga Operatori Ekonomik garanton implementim te plote te projektit

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termat e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.